

# Kosovë-Serbi deri më 2027: Katër skenarët më të mundshëm

shtator 2022



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*



**NEW  
SOCIAL  
INITIATIVE**

## **TITULLI**

Kosovë-Serbi deri më 2027: Katër skenarët më të mundshëm

## **PËR BOTUESIN**

Iniciativa e Re Sociale

## **AUTORË**

Raportin e hartoi kryetari i Bordit të NSI-së, Shpëtim Gashi

## **KONTRIBUES**

Agon Maliqi, Ardit Orana, Jovana Radosavljević, Katarina Tadić, Milica Andrić Rakić, Miloš Milovanović, Miodrag Marinković, Ramadan Ilazi, Sofija Todorović, Violeta Haxholli, Visar Xhambazi, dhe Visar Ymeri.

Ky dokument është shkruar fillimisht në anglisht.

## **PËRKTHIMI**

Trankos

## **DIZAJN DHE ILUSTRIME**

David Bilobrk

## **PRINTIMI (TIRAZHI)**

100

## **VITI I BOTIMIT**

shtator 2022

Ky publikim u zhvillua në kuadër të projektit Hulumto, Propozo, Angazhohu për të ndikuar në dialogun e lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, financuar nga Fondi Kombëtar për Demokraci dhe zbatuar nga OJQ Nova društvena inicijativa (Iniciativa e Re Sociale). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë ekskluzivisht të autoreve hulumtues dhe ato nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e NED.

# PËRMBAJTJAJ

<b>HYRJA</b> .....	<b>4</b>
<b>SKENARI A: PAQE PA NJOHJE</b>	<b>8</b>
<b>ELEMENTET KRYESORE TË SKENARIT</b> .....	<b>10</b>
<b>SUPOZIMET KYÇE TË SKENARIT, SHYTËSIT, NDRYSHIMET E POLITIKAVE DHE VEPRIMET</b> .....	<b>12</b>
<b>SKENARI B: NGËRÇI I VAZHDUESHËM</b>	<b>14</b>
<b>ELEMENTET KRYESORE TË SKENARIT</b> .....	<b>16</b>
<b>SUPOZIMET KYÇE TË SKENARIT, SHYTËSIT, NDRYSHIMET E POLITIKAVE DHE VEPRIMET</b> .....	<b>18</b>
<b>SKENARI C: UJËRAT E PAEKSPLORUAR</b>	<b>20</b>
<b>ELEMENTET KRYESORE TË SKENARIT</b> .....	<b>22</b>
<b>SUPOZIMET KYÇE TË SKENARIT, SHYTËSIT, NDRYSHIMET E POLITIKAVE DHE VEPRIMET</b> .....	<b>24</b>
<b>SKENARI D: KORRIGJIMI I KUFIRIT ME NJOHJE</b>	<b>26</b>
<b>ELEMENTET KRYESORE TË SKENARIT</b> .....	<b>28</b>
<b>SUPOZIMET KYÇE TË SKENARIT, SHYTËSIT, NDRYSHIMET E POLITIKAVE DHE VEPRIMET</b> .....	<b>29</b>
<b>PËRFUNDIM</b>	<b>30</b>

## RRETH DOKUMENTIT

Kosovë-Serbi deri më 2027: Katër skenarët më të mundshëm janë rezultat i disa ushtrimeve të “brainstorming” nga 13 ekspertë të politikave dhe aktivistë të shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia. Këta skenarë janë hartuar pa paragjykime nga pjesëmarrësit nga Serbia dhe Kosova - përkatësisht, shqiptarët dhe serbët e Kosovës - dhe shërbejnë si dokument se si ata e shohin gjendjen aktuale të qeverisjes. Qëllimi primar i tyre është të parashikojnë një të ardhme të mundshme të marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe kështu të provokojnë një debat mbi supozimet kryesore të nevojshme për t’i sjellë ato marrëdhënie drejt një stabiliteti të vazhdueshëm dhe për të paralajmëruar nëse këto të fundit mund të dërgojnë në drejtim të kundërt.

Dokumenti u shkrua dhe u redaktua gjatë katër sesioneve të veçanta të “brainstorming” të organizuara në prill dhe maj 2022, gjatë të cilave nevoja për të avokuar kundër status quo-së u shndërrua në çështjen më të diskutueshme. Disa pjesëmarrës gjithashtu u shprehën të zhgënjyer që asnjë skenar që përfshin njohjen e pakushtëzuar të Kosovës nga Serbia, nuk u konsiderua realist. Skenari i korigjimit të kufirit u konsiderua i pamundur gjatë sesionit të parë të “brainstorming”, me ç’rast vetëm tre skenarë u konsideruan si më realist, dhe u bënë të pashmangshëm me zhvillimin e diskutimeve.

Dokumenti është shkruar si pjesë e projektit të financuar nga Fondi Kombëtar për Demokraci që synon të përmirësojë zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit duke propozuar qasje të reja, përfshirë këtu tema të reja, palë të reja të interesit dhe duke zhvilluar politika alternative publike për përmirësime të mëtejshme në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

## HYRJA

Një grup prej 13 analistësh të apasionuar politikë nga Kosova dhe Serbia, të mbledhur nga Iniciativa e Re Sociale, një organizatë joqeveritare me bazë në Kosovë, zhvilluan katër skenarë në prill të vitit 2022 për një marrëveshje të mundshme paqeje deri në vitin 2027 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: 1) *Paqe pa njohje*, 2) *Ngërçi i vazhdueshëm*, 3) *Ujërat e paeksploruar* dhe 4) *Korigjimi i kufirit me njohje*. Rezultatet e skenarëve bazohen në disa supozime, nxitëse dhe ndërrime të politikave, dhe veprime të parashikuara që do të ndërmerren gjatë pesë viteve nga katër palët kryesore të interesuara në dialogun Kosovë-Serbi—Serbia, Kosova, BE-ja dhe SHBA-ja. **Një nxitës kyç i të gjithë skenarëve është shtrirja dhe shkalla e angazhimit të BE-së dhe SHBA-së.** Sa më i fortë të jetë angazhimi transatlantik, aq më e mirë është natyra e një zgjidhjeje, ndërsa nga ana tjetër, angazhimi minimal prodhon rezultate minimale. Mosangazhimi ndërkombëtar çon në shpërthimin e dhunës në shkallë të vogël në veriun e Kosovës me shumicë serbe dhe përgjatë kufirit Kosovë-Serbi. Nëse lihet i pambikëqyrur, konflikti në shkallë të vogël do të përshkallëzohej shpejt në dhunë të shkallës së plotë që mund të shndërrohet më tej në një konflikt të zgjatur ose në bisedime paqeje dhe në një marrëveshje të mëvonshme.

---

**Skenarët nuk parashikojnë asnjë rol për Rusinë dhe Kinën në një proces paqësor eventual.**

---

# VËSHTRIM I SHKURTËR I SKENARËVE

## SKENARI A, PAQE PA NJOHJE,

parasheh zgjidhjen e mosmarrëveshjes Kosovë-Serbi përmes një marrëveshjeje paqeje, ku Serbia heq dorë nga pretendimi i saj ndaj Kosovës – një njohje de facto – dhe Kosova ofron garanci shtesë për komunitetin e saj serb. Kjo zgjidhje do të balanconte kërkesën e drejtpërdrejt të Kosovës për njohje dhe ndjeshmërinë de jure të Serbisë për njohjen. Megjithëse përfitimet e marrëveshjes nuk do të ishin lehtësisht të vlerësueshme, të paktën jo në mënyra të menjëhershme dhe të matshme, publiku, si dhe elektorati kryesor i partive qeverisëse të Serbisë dhe Kosovës, do ta mbështesin atë, duke e bërë më të lehtë për qeveritë zbatimin e saj në përputhje me kushtet dhe afatet kohore të dakorduara. Vendosmëria e SHBA-së dhe BE-së, e nxitur kryesisht nga interesat gjeopolitike dhe të sigurisë, për të qetësuar rajonin është shtytësi kryesor për paqen. Në këtë skenar, Uashingtoni dhe Brukseli i përditësojnë rolet e tyre në mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi nga lehtësues të bisedimeve në ndërmjetës dhe, nëse është e nevojshme, arbitra dhe garantues të një marrëveshjeje përfundimtare të paqes. Ky është një prej skenarëve të mundshëm.

## SKENARI B, NGËRÇI I VAZHDESHËM,

parashikon që Kosova dhe Serbia të çlirohen nga ngërçi dhjetëvjeçar – duke i rianalizuar përparësitë dhe ngecjet – për të cilat u dakorduan menjëherë pas marrëveshjes së Brukselit në 2013. Palët do të vazhdojnë të marrin pjesë në dialogun e Brukselit, duke ofruar një qëndrim normal, por me rezultate jo mbresëlënëse. Ato mund të arrijnë marrëveshje të reja ose të përmirësojnë marrëveshjet e vjetra çdo gjashtë muaj ose më shumë, por po aq shpesh do të pësojnë edhe pengesa të mëtejshme. Në këtë skenar, paqja midis Serbisë dhe Kosovës do të ruhej, por perspektivat e brendshme ekonomike dhe politike do të përkeqësoheshin dhe një marrëveshje përfundimtare e paqes do të bëhej një perspektivë gjithnjë e më e largët. Shanset e Serbisë për anëtarësim në BE dhe perspektiva e Kosovës për avancimin e shtetësisë së saj në nivel ndërkombëtar do të vuanin ndjeshëm. Ky është një tjetër skenar i mundshëm, por që do të bëhej i paqëndrueshëm deri në 2027-ën, ose menjëherë pas saj.

## SKENARI C, UJËRAT E PAEKSPLORUAR,

parashikon një ngecje në Dialog, duke mohuar marrëveshjet e Brukselit dhe kthim në armiqësi sporadike, përfshirë ato të armatosura, të cilat mund të kenë pasoja shkatërruese dhe të kthehen në një konflikt të shkallës së gjerë. Ky është skenari më i paparashikueshëm, i cili po ashtu ngërthen tri drejtime, të gjitha të këqija, të mundshme ose mini-skenarë: a) dhunë e kontrolluar, b) dhunë e pakontrolluar që mund të çojë në konflikt të përmasave të plota dhe të zgjatura, dhe c) ajo që fillon si dhunë e shkallës së ulët përshkallëzohet shpejt në një konflikt të shkallës së plotë që nxit ndërhyrjen e fortë të BE-së dhe SHBA-së, dhe që rrjedhimisht çon në një marrëveshje paqeje, qoftë të negociuar ose të imponuar. Ky është një skenar më pak i mundshëm, por i besueshëm, dhe i frikshëm.

## SKENARI D, KORRIGJIMI I KUFIRIT ME NJOHJE,

parasheh që palët pa sukses i kanë shterur të gjitha përpjekjet për të arritur paqen. Supozimi kryesor për sukses në këtë skenar është konsensusi ndërmjet të gjitha palëve për korrigjimin e kufijve, gjë që e bën skenarin më pak të mundshëm. Ky skenar supozon se populli në Kosovë dëshiron një zgjidhje dhe është bërë më i hapur drejt një kompromisi që përfshin territorin. Në anën tjetër, Serbia e preferon këtë opsion dhe mund të garantojë se do ta njohë Kosovën në këmbim, duke përfunduar kështu njëherë e mirë konfliktin Serbi-Kosovë. SHBA-ja dhe BE-ja, duke përfshirë anëtarët skeptikë të BE-së, të rraskapitur nga operacionet e menaxhimit të paqes prej dy dekadash dhe të inkurajuar nga angazhimi i Kosovës dhe Serbisë për të mos kërkuar ndryshime të mëtejshme kufijsh në rajon, lehtësojnë një proces të tillë dhe mbështesin një marrëveshje për 'ndryshimin e kufijve'. Ky skenar përfshin një vendosmëri nga vendet e tjera në rajonin e Ballkanit Perëndimor për të mbështetur marrëveshjen dhe për të pranuar se ky është 'korrigjimi i fundit i kufijve' të rajonit. Ky është skenari më pak i mundshëm, por mund të bëhet realitet me parakushtet e duhura në dispozicion.



# Skenari A: Paqe pa njohje



## SKENARI A: PAQE PA NJOHJE

Rruga drejt këtij skenari është e ndërlikuar, por e realizueshme. Skenari supozon se BE-ja dhe SHBA-ja ndërmarrin përpjekje më të guximshme për të trajtuar rreziqet e mbetura të sigurisë nën përgjegjësinë e Evropës, duke u fokusuar në mosmarrëveshjen Serbi-Kosovë. Është ambicioze por edhe racionale të pritet që SHBA-ja dhe BE-ja të përfshijnë mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi në strategjinë e tyre të sigurisë transatlantike në zhvillim, duke pasur parasysh sjelljen mashtruese të Rusisë dhe mbylljen e kësaj mosmarrëveshje prej dy dekadash në Evropë

**Meqenëse BE-së i mungon kohezioni i politikës së brendshme për mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi, i nevojshëm për udhëheqjen e një procesi negociues efektiv, SHBA-të, sipas këtij skenari, do të luanin një rol gjithnjë e më përcaktues, kryesisht në prapaskenë, në ndërmjetësimin dhe arbitrimin e një zgjidhjeje.**

Megjithatë, BE-ja do të mbetet thirrësi zyrtar i bisedimeve.

## ELEMENTET KRYESORE TË SKENARIT

- Serbia heq dorë nga pretendimi i saj për Kosovën përmes një marrëveshjeje ligjërimit të detyrueshme me të cilën ajo njuh të gjitha institucionet dhe dokumentet e Kosovës, ndalon fushatën e çnjohjes dhe nuk kundërshton anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare.
- Kosova formon Asociacionin/Komunitetin e Komunave me Shumicë Serbe (A/KKS) në një mënyrë të pranueshme për komunitetin serb në Kosovë, Beograd, dhe interpretimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 të Marrëveshjes së 2015-ës mbi parimet e A/KKS. Për më tepër, Kosova ofron masa mbrojtëse shtesë për pamjet e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe. Komuniteti serb gjithashtu integrohet plotësisht në sistemin politik dhe ekonomik të Kosovës.

- Serbia mbyll Kapitullin 35 – i cili në thelb kushtëzon aspiratat e Serbisë për anëtarësim në BE me një marrëveshje gjithëpërfshirëse normalizimi me Kosovën – dhe përfiton nga mekanizmat e para-anëtarësimin të BE-së, duke përmirësuar ndjeshëm perspektivën e saj për anëtarësim në BE.
- Serbia përafrohet gjithnjë e më shumë me politikën e jashtme të BE-së ndaj Rusisë, duke përfshirë vendosjen e disa sanksioneve – edhe pse ndjenja serbe mbetet kryesisht kritike ndaj Perëndimit – pasi presidenti rus Vladimir Putin bëhet gjithnjë e më i izoluar dhe jo i besueshëm, ndërkaq ndarja e rrugëve me një Putin të dobët nuk përbën më një rrezik të madh për
- presidentin Vuçiç. Rrjedhimisht, Rusia nuk është më një aktor i rëndësishëm në procesin e negociatave, qoftë edhe në mënyrë indirekte. Edhe pse ruan njëfarë kapaciteti për të prishur procesin nëpërmjet elementëve mashtrues në rajon, Rusia nuk mund të ndikojë në drejtimin e negociatave dhe përmbajtjen e marrëveshjes
- **Pesë shtetet anëtare të BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën – Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja – do ta njohin Kosovën menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes.** Këto pesë vende ofrojnë ose garanci publike gjatë negociatave ose angazhime private përmes kanaleve konfidenciale të lehtësuara nga SHBA-ja që çdo marrëveshje, me ose pa njohje *de jure*, me nënshkrimin e Serbisë në të, është e pranueshme për ta, sepse ata do të argumentonin se lëvizjet e tyre separatiste të brendshme nuk mund ta përdorin më pavarësinë e Kosovës si precedent për të çuar përpara aspiratat e tyre për pavarësi pasi marrëveshja do të transformonte *shkëputjen e njëanshme* të Kosovës nga Serbia bazuar në një *zgjidhje të negociuar*.
- Kosova i bashkohet një numri organizatash shumëpalëshe dhe agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara si Interpoli dhe UNESCO- duke supozuar se garancitë e trashëgimisë kulturore plotësojnë kërkesat e Beogradit- por jo OKB-së për shkak të izolimit ndërkombëtar të Rusisë dhe vetos së saj të mundshme. Kosova hyn edhe në bisedimet zyrtare të anëtarësimin me NATO-n.

# SUPOZIMET KYÇE TË SKENARIT, SHTYTËSIT, NDRYSHIMET E POLITIKAVE DHE VEPRIMET

- BE-ja dhe SHBA-ja i konsiderojnë mosmarrëveshjet e Ballkanit Perëndimor si burime të rëndësishme jostabiliteti për Evropën dhe i trajtojnë ato në përputhje me rrethanat në kuadër të politikës së tyre të re dhe më të fortë të sigurisë që ka marrë formë pas agresionit rus në Ukrainë. Sipas këtij skenari, ato luajnë një rol përcaktues në ndërmjetësimin dhe, nëse është e nevojshme, në imponimin e zgjidhjeve si në Kosovë ashtu edhe në Bosnjë e Hercegovinë. SHBA-ja dhe BE-ja janë të lidhura nga kërcënimet e përbashkëta po aq sa edhe nga vlerat e përbashkëta. Andaj, mosmarrëveshja Kosovë-Serbi është një kërcënim i madh nën përgjegjësinë e tyre dhe një kërcënim për të cilin BE-ja dhe SHBA-ja mund të ndërtojnë lehtësisht konsensus për një kurs veprimi. BE-ja zyrtarisht do të ruante rolin udhëheqës në procesin e negociatave ndërkohë që SHBA-ja do të rrisë angazhimin e saj në formësimin dhe shtyrjen e zgjidhjeve në prapaskenë. Politikat e BE-së dhe SHBA-së përfshijnë gjithashtu ndëshkime të forta për jo-bashkëpunëtorët, bashkëpunëtorët e tyre të ngushtë dhe anëtarët e familjes, duke përfshirë sanksionet financiare dhe izolimin diplomatik
- **Rreziqet gjeopolitike i shtyjnë Serbinë dhe Kosovën të zbutin kërkesat dhe pozicionet e tyre, duke e parë gjithnjë e më shumë një marrëveshje si një domosdoshmëri dhe jo si një zgjedhje.** Si Serbia ashtu edhe Kosova dhe liderët e tyre janë të cënueshëm ndaj mosmarrëveshjes. Kosova pranon të pajtohet me një marrëveshje pa njohje eksplicite pasi hapësira e saj e manovrimit ngushtohet në hapësirën gjeopolitike që ndryshon me shpejtësi, në të cilën ripozicionimi eventual pro-BE i Serbisë mund ta vendosë Kosovën nën presionin e BE-së dhe SHBA-së. Beogradi anon të vendos për një zgjidhje joterritoriale – duke braktisur kështu politikën e ‘korrigjimit të kufijve’ – pas luftës ukrainase meqenëse oreksi ndërkombëtar për ndryshime kufijsh bie ndjeshëm
- Po ashtu, partia e presidentit serb Aleksandër Vuçiq vazhdon të dobësohet dhe ai bëhet më i ndjeshëm ndaj presionit të BE-së dhe SHBA-së. Me ç’rast, ai do ta përdorte marrëveshjen për të përmirësuar pozitën e tij jashtë vendit

si njeri i paqes pa rrezikuar tjetërsimin e pakthyeshëm të mbështetësve të tij kryesorë partiak. BE-ja dhe SHBA-ja do të siguroheshin gjithashtu që kushtet e marrëveshjes të paqes të mos jenë mjaft të ashpra – duke përjashtuar njohjen e plotë – për të minuar pushtetin politik të Presidentit Vuçiq. z.Vuçiq mbetet partneri kryesor perëndimor, pasi partitë opozitare në Serbi vazhdojnë të jenë ose haptazi antiperëndimore ose në mënyrë të paqartë properëndimore. Nëse diplomacia nuk tregon rezultat, BE-ja dhe SHBA-ja mund të përdorin gjithashtu masa shantazhuese ndaj të cilave presidenti Vuçiq ka shumë gjasa të përgjigjet pozitivisht.

- Në kontekstin e politikës mashtruese të sigurisë ruse, pesë shtetet anëtare të BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën i përafrojnë politikat e tyre të jashtme dhe të sigurisë me politikat e SHBA-së dhe BE-së dhe argumentojnë vendimin e tyre për njohjen e Kosovës mbi kushtet evropiane të sigurisë dhe jo mbi kërcënimet e precedentëve të brendshëm. Njohja e tyre ul ndjeshëm fuqinë negociuese të Serbisë mbi Kosovën dhe ngushton hapësirën e manovrimit të Presidentit Vuçiq
- **Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, zvogëlojnë pakënaqësinë publike bazuar në motive etnike duke ndërtuar kështu retorikë më miqësore, dhe duke nxjerrë në pah përfitimet e një zgjidhjeje paqësore dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore.**
- Procesi i negociatave dhe marrëveshja pasuese kanë mbështetje politike dypartiake si në Kosovë ashtu edhe në Serbi, por veçanërisht në Kosovë, ku kryeministri Kurti është më i prekshëm ndaj një marrëveshjeje me Serbinë, pasi ai ka ndihmuar në forcimin e një ndjenje anti-Serbie për të ardhur në pushtet dhe një marrëveshje pa njohje me vendin që ai fajëson për gjenocid, e cila mund të shihet nga publiku dhe mbështetësit e tij kryesorë të partisë, si një ndryshim joparimor i politikës.
- Në këtë skenar, të dyja palët kanë kushte të panegociueshme: Serbia refuzon ta njohë Kosovën *de jure*. Në të kundërt, Kosova refuzon t’i ofrojë komunitetit serb një nivel më të lartë të autonomisë përmes A/KKS. Prandaj, ky skenar parashikon një marrëveshje që përfshin *gjithçka përveç njohjes*. Serbia heq dorë nga aspiratat e saj për të ri-inkorporuar Kosovën ose një pjesë të saj në Serbi, dhe Kosova ofron mbrojtje dhe të drejta shtesë për komunitetin e saj serb përmes një versioni më të butë të A/KKS. Rezultati apelon për pjesë mjaft të mëdha të popullsisë, duke penguar kështu çdo destabilitet të brendshëm, siç janë protestat me përmasa të mëdha për të rrëzuar qeveritë.



# Skenari B: Ngërçi i vazhdueshëm



## SKENARI B: NGËRÇI I VAZHUESHËM

Ky skenar parasheh që Kosova dhe Serbia të çlirohen nga ngërçi i vazhdueshëm për të cilin u dakorduan menjëherë pas marrëveshjes së Brukselit në 2013. Ato do të vazhdojnë të angazhohen në dialogun e Brukselit të lehtësuar nga BE-ja, por pa rezultate apo përparime konkrete. Dialogu mbetet shumë i fokusuar, duke lëvizur më tej nga niveli makro në atë mikro. Qasja i transformon marrëdhëniet Kosovë-Serbi në një proces që rregullon problemet thelbësore që mundojnë marrëdhëniet. Në këtë skenar, udhëheqësit hezitojnë të prishin status quo-në, nga frika se kjo mund t'u kushtojë atyre politikisht.

**BE-ja dhe SHBA-ja besojnë se ruajtja e kësaj paqeje të qëndrueshme është më e mira që ato mund të bëjnë duke marrë parasysh rrethanat. Ato mbeten të zëna me politikën mashtruese të sigurisë ruse, kështu që i gjithë Ballkani Perëndimor zë vendin e dytë në politikën e jashtme SHBA-BE.**

## ELEMENTET KRYESORE TË SKENARIT

- Do të ketë një proces politik, por shumë pak të përpunuar. Dialogu i Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga BE-ja vazhdon të përdorë një qasje të ngjashme, duke trajtuar mosmarrëveshjet e vogla që ndodhin herë pas here, si kërcënimet e sigurisë në veri, ose përmirësimi i disa marrëveshjeve, si targat e veturave apo dokumentet e udhëtimit. **Dialogu synon të ruajë stabilitetin sesa të kërkojë një zgjidhje.** Ndonëse liderët e Kosovës dhe Serbisë nuk e kanë ndërmend të arrijnë një zgjidhje, ata angazhohen në Dialog në mënyrë që të mos e largojnë bashkësinë ndërkombëtare ose të mos rrezikojnë të duken shkatërrues para tyre. Në planin afatgjatë, ky skenar është i paqëndrueshëm por mund të mbijetojë gjatë pesë viteve të ardhshme.
- Shtetësia e Kosovës ndërkombëtarisht mbetet në harresë. Ajo nuk anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare, nuk ka njohje të reja, duke përfshirë edhe pesë shtetet anëtare të BE-së që ende nuk e kanë njohur

atë dhe disa vende mund të tërheqin njohjet e tyre gjatë kësaj periudhe. Po ashtu, dështon edhe përpjekja e Kosovës për statusin e kandidatit në BE.

- Perspektivat e Serbisë për anëtarësim në BE mbeten të dobëta, me shumë pak progres në kapitujt e BE-së. Sundimi i ligjit dhe liria e fjalës në Serbi gjithashtu vazhdojnë të përkeqësohen.
- Serbia ruan një farë ekuilibri gjeostrategjik midis SHBA-së dhe BE-së dhe Ruisë dhe Kinës, duke aplikuar disa sanksione simbolike ndaj Ruisë – mjaftueshëm për të mos e mërzhitur BE-në – por ajo kryesisht ndjek një politikë të jashtme të paangazhuar. Kina vazhdon të rrisë ndikimin e saj përmes kredive dhe projekteve të ndërtimit në Serbi.
- Marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë mbeten të tensionuara, por të qëndrueshme, me ndarjet etnike dhe mosbesimin ende të gjithëpranishëm.
- Frustrimi i publikut me stagnimin ekonomik rritet në Kosovë dhe Serbi, dhe shkëndijat e trazirave të mundshme sociale shfaqen para vitit 2027. Frustrimi eventual i publikut të brendshëm i ndjekur nga trazira sociale mund të shqetësojë dhe të minojë ngërçin e
- vazhdueshëm, veçanërisht nëse udhëheqësit arrijnë ta përkthejnë zhgënjimin shoqëror në urrejtje etnike dhe ta kanalizojnë atë për përfitime politike.

# SUPOZIMET KYÇE TË SKENARIT, SHTYTËSIT, NDRYSHIMET E POLITIKAVE DHE VEPRIMET

- Mosmarrëveshja duket e pazgjidhshme për të gjitha palët—Prishtinën, Beogradin, Brukselin dhe Uashingtonin—kështu që ato angazhohen në kontrollimin e faktorëve të rrezikut në vend që t'i zgjidhin ato. Kosova dhe Serbia mbeten të barrikaduara pas qëndrimeve të tyre maksimaliste: Njohje pa kushte kundrejt asnjë njohjeje në asnjë rrethanë. **Parimet dhe kërkesat kundërshtuese vazhdojnë: Serbia zyrtarisht dëshiron anëtarësim dhe stabilitet në BE, por nuk heq dorë nga Kosova. Kosova zyrtarisht dëshiron paqe me Serbinë, por njëkohësisht promovon retorikë armiqësore kundër Serbisë..**
- SHBA-ja dhe BE-ja vazhdojnë të besojnë se aksionet në këtë mosmarrëveshje janë të ulëta, kështu që angazhimi i tyre mbetet minimal dhe po ashtu edhe rezultatet që pasojnë. Ato fokusohen në arritjet e dialogut të Brukselit dhe parandalimin e përshkallëzimit të mundshëm në vend që të nxisin për një zgjidhje.
- Mosmarrëveshja mbetet në fluks të vazhdueshëm, të paparashikueshëm, me faktorë të brendshëm rreziku, që mund të çojnë në konflikt në planin afatgjatë, por duken paqësore në sipërfaqe.
- Presidenti i Serbisë Vuçiq beson se zgjatja e Dialogut është në interesin e tij.
- Kryeministri i Kosovës Kurti vazhdon të mos i besojë presidentit Vuçiq dhe, për rrjedhojë, nuk do të ndërmarrë asnjë iniciativë – edhe nëse beson se ngërçi nuk është në interesin e Kosovës – për të sugjeruar negociata reale dhe për ta prishur atë.
- Publiku i Serbisë dhe Kosovës mbeten të pafavorshëm për një zgjidhje kompromisi dhe fajësojnë liderët e njëri-tjetrit për moszbatimin e asaj që tashmë është rënë dakord. Ngushtësia e pozicioneve të Serbisë dhe Kosovës do ta pengojë publikun që të përpiqet të kuptojë rëndësinë e një marrëveshjeje paqeje.



# Skenari C: Ujërat e paeksploruar





## SKENARI C: UJËRAT E PAEKSPLORUAR

Skenari C, *Territori i paeksploruar*, është më i paparashikueshëm, dhe pa drejtim të qartë në pesë vitet e ardhshme. Ky skenar përfshin në vete disa mini-skenarë: a) dhunën e kontrolluar, b) dhunën e pakontrolluar që mund të çojë në konflikt të përmasave të plota dhe të zgjatura, dhe c) ajo që fillon si dhunë e shkallës së ulët përshkallëzohet shpejt në një konflikt të shkallës së plotë që nxit ndërhyrjen e fortë të BE-së dhe SHBA-së, dhe që rrjedhimisht çon në një marrëveshje paqeje.

### ELEMENTET KRYESORE TË SKENARIT

- **Kosova dhe Serbia e përdorin Dialogun si një mjet për të provokuar dhe përshkallëzuar tensionet, duke e shndërruar dialogun e Brukselit nga një mjet lehtësues në një mekanizëm tensionues.** Motivimet e liderit për nxitjen e dhunës mund të jenë të ndryshme: Presidenti i Serbisë Vuçiç mund të shpresojë se tensionet në shkallë të gjerë mund të çojnë në ndarje, opsioni i preferuar i Beogradit. Në të njëjtën kohë, Kurti i Kosovës mund të besojë se dhuna e pakontrolluar mund të shkaktojë veprime vendimtare të BE-së dhe SHBA-së kundër Serbisë dhe të çojë në një zgjidhje në favor të Kosovës.
- Serbia dhe Kosova hedhin poshtë marrëveshjet e Brukselit dhe anulojnë zbatimin e marrëveshjeve tashmë të zbatuara, përfshirë dokumentet e udhëtimit dhe targat e makinave, duke mbyllur në thelb kufirin. Përpjekjet dhe progresi dhjetëvjeçar përmbysen brenda javësh. Kosova dhe Serbia bëhen të izoluara ndërkombëtarisht dhe gjithnjë e më shumë nacionaliste brenda vendit. Kjo mund të çojë në mini-skenarin A, *dhunë e kontrolluar*.
- Serbët në veri të Kosovës tërhiqen nga të gjitha institucionet e Kosovës – gjykatat, policia, institucionet qendrore dhe lokale – dhe rithemelojnë institucionet e tyre paralele. Kosova dërgon policinë e saj për t'iu kundërvënë këtyre veprimeve. Serbët përgjigjen duke organizuar një 'rebelim' të armatosur, që e shtyn Kosovën të dërgojë Forcat e Sigurisë së Kosovës për të shuar rebelimin, dhe duke e shndërruar veriun në një

zonë aktive konflikti midis policisë së sigurisë së Kosovës dhe serbëve të armatosur. Ndonëse rreziku i një konflikti të hapur me Kosovën është shumë i lartë, duke pasur parasysh praninë e forcave të NATO-s, Beogradi i dorëzohet presionit publik serb. Ai dërgon ushtrinë e tij në veri, duke u përplasur hapur me forcat e Kosovës. E gjithë kjo ndodh aq shpejt sa trupat e NATO-s nuk kanë kohë për të parandaluar konfliktin dhe ngurrojnë të hyjnë mes dy palëve duke qëlluar kundër njëri-tjetrit. Kjo çon në mini-skenarin B, *konflikt në shkallë të plotë*.

- BE-ja dhe SHBA-ja ulin angazhimin e tyre, të lodhur nga incidentet e dhunshme të përditshme, riangazhohen sapo situata të dalë jashtë kontrollit dhe imponojnë një zgjidhje në të dyja palët. Me fillimin e konfliktit të plotë ndërmjet forcave të Kosovës në njërin anë dhe forcave të Serbisë dhe serbëve të armatosur në veri në anën tjetër, KFOR-i ndërhyr dhe merr përsipër sigurinë në veri, duke dëbuar nga veriu forcat serbe dhe kosovare. Kjo mund të çojë në mini-skenarin C, *një marrëveshje e imponuar paqeje*, duke nxitur BE-në dhe SHBA-në të imponojnë një zgjidhje si për Prishtinën ashtu edhe për Beogradin.
- Rusia do të kishte dorë në këtë konflikt në veri, me shumë gjasa duke anashkaluar qeverinë serbe dhe duke punuar drejtpërdrejt me grupe të caktuara radikale të serbëve në Serbi dhe në veri të Kosovës.

## SUPOZIMET KYÇE TË SKENARIT, SHTYTËSIT, NDRYSHIMET E POLITIKAVE DHE VEPRIMET

- Udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë ndërtojnë pasiguri, konfuzion dhe mosbesim. Ka një rigjallërim të gjuhës së urrejtjes në Serbi dhe Kosovë. Udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë, duke u izoluar gjithnjë e më shumë nga Perëndimi dhe duke u përballur me depresionet ekonomike në vend, mbështeten në retorikën populiste për mbijetesën e tyre politike dhe vazhdojnë të shfrytëzojnë dhe kanalizojnë ankesat etnike për përfitime politike. Duke e paraqitur veten si mbrojtës të interesave kombëtare ata përçojnë një mesazh që gjen simpati të fortë në mesin e mbështetësve dhe popullatave të tyre partiake.
- Me perspektiva të pasigurta dhe të paqëndrueshme, Kosova dhe Serbia bëhen ekonomikisht më të dobëta dhe politikisht të paqëndrueshme. Konkurrenca politike në vend bëhet agresive, me normat demokratike dhe liritë politike që vuajnë ndjeshëm. Kriza e ushqimit dhe energjisë përkeqësohet, inflacioni rritet në qiell dhe rritja ekonomike ngec, duke çuar në trazira të mëdha sociale në Kosovë dhe Serbi. Të rinjtë, të arsimuarit dhe krijuesit largohen në numër të madh dhe triumfojnë nacionalistët e ashpër, dhe autoritarë. Trazirat sociale kërcënojnë pushtetin e Presidentit të Serbisë Vuçiq dhe kryeministrit të Kosovës Kurti, dhe si rezultat, ato shkaktojnë konfrontim etnik për të zgjatur qëndrimin e tyre në pushtet përmes të *qenurit kurban*.
- **Rezultatet e Dialogut bindin të dyja palët se një zgjidhje e negociuar është e paarrtshme.** Pason konflikti me intensitet të ulët në veriun e Kosovës, duke minuar në përgjithësi perspektivat për paqe të qëndrueshme. Konfrontimet përshkallëzohen edhe përgjatë kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.
- BE-ja dhe SHBA-ja do ta shohin gjithnjë e më shumë Kosovën dhe Serbinë si jo të besueshme dhe do të fillojnë të shkëputen.
- KFOR-i ngurron të ndërhyjë për të parandaluar incidentet në rritje mes serbëve dhe shqiptarëve në veri, duke besuar se dhuna e shkallës së ulët nuk do të përshkallëzohej jashtë kontrollit dhe kështu nuk ndërhyr derisa të bëhet tepër vonë.
- Një supozim në këtë skenar është se sado të mëdha të jenë urrejtjet dhe pakënaqësitë dhe sado që serbët dhe shqiptarët të kenë inat njëri-tjetrit, ata do të mbeten mjaftueshëm racionalë për të mos u përfshirë në një luftë të gjithanshme, vetëshkatërruese.

# Skenari D: Korrigjimi i kufirit me njohje



## SKENARI D: KORRIGJIMI I KUFIRIT ME NJOHJE

Skenari D, *Korrigjimi i kufirit me njohje*, është skenari i fundit vetëm nëse të gjitha palët mendojnë se kanë shteruar të gjitha opsionet e tjera. Supozimi kryesor i këtij skenari është se një marrëveshje territoriale ka nevojë për konsensusin e të katër aktorëve – Prishtinës, Beogradit, Uashingtonit dhe Brukselit – dhe kjo ndodh në mënyrë paqësore. Marrëveshja do të kishte nevojë për një lloj vërtetimi popullor përmes konsensusit parlamentar ose referendumit.

### ELEMENTET KRYESORE TË SKENARIT

- Prishtina dhe Beogradi janë dakord në parim për korrigjimin e kufirit. Pas dyerve të mbyllura, Uashingtoni dhe Brukseli miratojnë shkëmbimin e veriut të Kosovës me shumicë serbe me luginën e Preshevës me shumicë shqiptare të Serbisë dhe punojnë drejt përgatitjes së komunitetit ndërkombëtar për marrëveshjen.
- **Serbia e njeh Kosovën de jure dhe nuk lobon kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, përfshirë OKB-në. Në këmbim, BE-ja përshpejton ofertën e Serbisë për anëtarësim në BE.**
- Pesë shtetet anëtare të BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën e njohin atë, dhe Kosova vazhdon me integrimin e saj euroatlantik. Serbia nga ana tjetër mbyll të gjithë kapitujt e BE-së dhe bën lëvizjen përfundimtare për t'u anëtarësuar në BE.
- Serbia dhe Kosova angazhohen ligjërisht të mos kërkojnë ndryshime të mëtejshme kufitare në rajon: Kosova heq dorë nga ambicia e saj për t'u bashkuar me Shqipërinë, ndërsa Serbia heq dorë nga ambicia e saj për të inkorporuar Republikën Srpska në Serbi.

- Modifikimet kushtetuese të Kosovës përfshijnë reduktimin e numrit të vendeve të rezervuara për komunitetin serb dhe eliminimin e legjislacionit shumicë e dyfishtë.
- BE-ja dhe SHBA-ja ofrojnë ndihmë ekonomike për Kosovën dhe Serbinë.

### SUPOZIMET KYÇE TË SKENARIT, SHTYTËSIT, NDRYSHIMET E POLITIKAVE DHE VEPRIMET

- **Kosova dhe Serbia nuk tregojnë gatishmëri për të negociuar një zgjidhje. Dialogu i Brukselit nuk shkon askund. Të gjitha opsionet janë shteruar dhe të gjitha palët ndihen të lodhura dhe pa dëshirë pajtohen me këtë skenar jokonvencional.**
- Fë frustruar nga perspektivat e dobëta ekonomike, një numër në rritje i popullsisë shqiptare të Kosovës mbështet shkëmbimin e opsioneve të territorit. Ai lobon hapur për të, me gjithnjë e më shumë shqiptarë që e përqafojnë këtë opsion.
- Ky mbetet i vetmi skenar sipas të cilit serbët në Serbi japin pëlqimin për njohjen zyrtare të Kosovës dhe votën pro ndryshimeve të kërkuara kushtetuese.
- Të frustruar nga mungesa e progresit në Dialog, BE-ja dhe SHBA-ja mbështesin opsionin.
- Mund të ndodhë gjithashtu që të trija palët – SHBA-ja, BE-ja dhe Serbia – të bien dakord fillimisht për opsionin dhe pastaj t'i bëjnë presion Kosovës.
- Marrëveshja nuk minon stabilitetin rajonal dhe nuk ka ndryshime të mëtejshme kufitare pas marrëveshjes. Unifikimi dhe ambiciet territoriale në Kosovë dhe Serbi mbeten, por komuniteti ndërkombëtar është ai që i kontrollon ato.



## PËRFUNDIM

**Supozoni se po e studiojmë thelbësisht konfliktin Kosovë-Serbi. Në atë rast, ne gjejmë dy tipare kryesore: a) Serbia de facto pranon se Kosova është një entitet i veçantë, por ajo dëshiron diçka në këmbim të nënshkrimit të dokumenteve të ndarjes, dhe b) Kosova dëshiron një ndarje ligjore me Serbinë në formën e njohjes de jure, por nuk dëshiron të japë asgjë në këmbim, duke këmbëngulur për ndarje pa kushte.** Ashtu siç është krijuar aktualisht, konflikti nuk mund të zgjidhet, të paktën jo elementi themelor i mosmarrëveshjes, mosnjohja nga ana e Serbisë. Një parakusht për një zgjidhje është një konstrukt i ri retorik që ripërcakton termat, kërkesat dhe çështjet aktuale të konfliktit. Dhe kompromisi është një marrëveshje efektive përmes së cilës mund të trajtohet kjo çështje. **Asnjë nga katër skenarët nuk parashikon që Serbia do ta njohë Kosovën pa kushte, ku të katërt përfshijnë një shkëmbim ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.**

Skenari A, *Paqe pa njohje*, është më i favorshëm se tre të tjerët pasi, edhe pse neglizhon çështjen kyçe të njohjes de jure, i çon marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në një nivel më të lartë, duke krijuar mundësisht kushtet për njohje de jure në një fazë të mëvonshme. Skenari B, *Ngërçi i vazhdueshëm*, është më pak i preferuar se skenari A, por më i preferueshëm se skenari C, pasi të paktën parandalon një shpërthim armiqësish. Megjithatë, ai është i paqëndrueshëm përtej pesë viteve të mbuluara nga skenari, pas të cilave mund të shfaqet dhuna. Skenari C, *Ujërat e paeksploruar*, është i frikshëm, gjithashtu një opsion i pamundur, por jo i paimagjinueshëm. Ky skenar do ta kthente Kosovën dhe Serbinë në konfliktin e hapur të vitit 1999. Skenari D do të hynte në lojë vetëm pasi të gjitha opsionet e tjera të jenë shterur dhe të gjitha palët të ndjehen të lodhura nga negociatat e gjata e të pafrytshme. Ky skenar kërkon konsensusin e të gjitha palëve dhe ndodh në mënyrë paqësore, me një shkëmbim territoresh por jo popullsie.

Diskutimi i zhvillimit të skenarit theksoi se një zgjidhje kërkon që liderët e Kosovës dhe Serbisë të lënë mënjane politikën ditore, të ndërtojnë dhe t'u përmbahen vizioneve afatgjata për vendet e tyre dhe të marrin disa rreziqe politike afatshkurtra për përfitime kombëtare afatgjata, të cilat përfshijnë perspektivat ekonomike, perspektivat e BE-së dhe stabilitetin. Me fjalë të tjera, një marrëveshje paqeje mund të arrihet vetëm nëse negociatat dhe një marrëveshje pasuese e paqes trajtojnë në masë të madhe të ardhmen

e marrëdhënieve Serbi-Kosovë në vend që të dominohen nga e kaluara. **Një Kosovë dhe Serbi në paqe me njëra-tjetrën nuk është i paimagjinueshëm.** Madje ka pasur disa periudha në të cilat serbët dhe shqiptarët kanë jetuar në paqe. Andaj, rikthimi i tyre në një gjendje të ngjashme apo edhe më të mirë të marrëdhënieve është i mundur.

[newsocialinitiative.org](https://newsocialinitiative.org)

+38128497180

Čika Jovina V/117, North Mitrovica

[office@newsocialinitiative.org](mailto:office@newsocialinitiative.org)